

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Hashim Çollaku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vjollca Kurtishaj, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.R., nga fshati ..., Komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, P.nr.276/2016, datë 22.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 08.11.2018, mori këtë:

A KTGJYKIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, P.nr.276/2016, datë 22.06.2018, vërtetohet

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, me aktgjykimin P.nr.276/2016, datë 22.06.2018, të akuzuarin F.R., konform nenit 364 nenpar.1.3 të KPPK-së, e ka liruar nga akuza për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1, të KPRK-së, I dëmtuari L.P.K. nga fshati ..., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil. Shpenzimet e procedurës i janë vënë në barrë mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.965/2018 të datës 09.10.2018, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të aprovet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Prokurori me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, se gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së katër seancave, pas dëgjimit të dëshmitarit XH.E., të dëmtuarit L.K., ekspertit të komunikacionit si dhe administrimit të provave që gjenden në shkresa të lëndës, ka vendosur se në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme për ta shpallur fajtor të akuzuarin për veprën penale për të cilën është akuzuar. Sipas ankesës, gjykata me rastin e lirit nga akuza për të pandehurin e sipërshtetë i cili nuk e ka pranuar veprën penale, është bazuar vetëm në deklaratën e ekspertit të komunikacionit sipas të cilit, aksidenti është bërë me lëshimet e të dëmtuarit-të miturit 12 vjeçar i cili ka dalë në trafik pa përkujdesjen e prindit dhe ka drejtuar biçikletën pa drita. Prokurori me ankesë thekson se është fakt i pa kontestueshëm se në momentin kritik i dëmtuari kishte qenë duke lëvizur me biçikletë në rrugë me përparësi kalimi i cili është goditur me pjesën ballore të automjetit dhe pas aksidentit të shkaktuar automjeti ishte larguar nga vendi i ngjarjes. Sipas ankesës, edhe pse i dëmtuari ka vozitur biçikletën ende pa e plotësuar moshën e duhur kjo nuk i justifikon lëshimet e drejtuesit të automjetit, çka do të thotë se lëshimet kanë qenë të drejtuesit të automjetit tani të pandehurit F.R.. Sipas ekspertizës së komunikacionit del se lëshimet e biçiklistit ishte mosha dhe nuk posedonte pajisje ndriçuese ku drejtuesi i automjetit nuk e ka vërejtur. Sipas prokurorit gjykata aktgjykimi lirues e ka nxjerrë vetëm duke u bazuar në ekspertizën e komunikacionit dhe deklaratën e ekspertit ku sipas prokurorit provat e tjera tregojnë se aksidenti i komunikacionit është shkaktuar me lëshimet e të pandehurit dhe gjykata është dashur që ti merr parasysh me rastin e vendosjes.

Kolegji penal i kësaj Gjykate i vlerëson si të pabazuara pretendimet ankimore të Prokurorit, se aktgjykimi i ankimuar është mbështetur në gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë e si pasojë e vlerësimit të gabuar të provave, të akuzuarin F. e ka liruar nga akuza. Gjykata e shkallës së parë në bazë të deklaratave të dëshmitarit XH.E., deklaratës dhe ekspertizës së ekspertit të komunikacionit A.T., si dhe provave të administruara, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar të gjitha faktet relevante të kësaj çështje juridiko - penale, në bazë të këtyre ka nxjerrë konkludime të drejta dhe të ligjshme, arsye të cilat i ka dhënë në arsyetimin e aktgjykimi të ankimuar si të drejta dhe të ligjshme në tërësi i aprovon edhe kjo gjykatë. Me ankesë sa i përket kësaj baze ankimore, me asgjë nuk vihet në dyshim gjendja e fakteve, të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj pa bazë ankimohet aktgjykimi me ankesë sa i përket kësaj baze ankimore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe konkret, në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme juridike dhe faktike, të cilat, si të drejta, i aprovon edhe kjo Gjykatë. Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të KPPK, duke e paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për cilat arsye i merr si të vërtetuara ose të pa vërtetuara e duke dhënë vlerësimin e saktësisë së provave kontradiktore. Ajo ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat i aprovon edhe kjo Gjykatë, ngase nga dëshmia e dëshmitarit XH.E., zyrtar policor, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se në rastin kritik, tani i dëmtuari L.K., ka vozitur biçikletën, së cilës nuk i kanë funksionuar dritat, detaj ky që ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit e që bie në kundërshtim me deklaratën e tani të dëmtuarit i cili ka deklaruar se biçikleta e tij ka pasur drita. Gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e ankimuar në veçanti e ka bazuar në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit, A.T. të datës 29.01.2018 dhe deklaratën e tij, dhënë në shqyrtimin gjyqësor, sipas të cilave, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e gabimit të biçiklistit, i cili ka vozitur biçikletën pa e plotësuar moshën e duhur, sepse sipas ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e aksidentit në fjalë, për ngasje të biçikletës, ngasësi është dashur të ketë mbushur 14 vjet ndërsa tani i dëmtuari në

atë kohë ka pasur vetëm 12 vjet. Sipas ekspertizës së komunikacionit, gabim tjetër e që është edhe shkak i këtij aksidenti, është edhe ngasja e biçikletës e cila nuk ka poseduar pajisje ndriçuese- drita e për këtë shkak, ngasësi i automobilin respektivisht tani i akuzuari nuk e ka vërejtur që dikush ishte duke lëvizur në anën e djathtë. Eksperti i komunikacionit në Mendimin e dhënë të tij ka konstatuar se sa i përket gabimeve të mundshme të tani të akuzuarit ka dhënë mendimin e tij se po të kishte pasur biçikleta drita, atëherë tani i akuzuari do të duhej që ti jepte përparësi biçiklistit pasi që normalisht do të duhej që tani i akuzuari ta vërente biçikletën me dritë dhe se në rast aksidenti, shkaktar do të ishte mosrespektimi i përparësisë së kalimit nga tani i akuzuari. Sipas ekspertizës së lartcekur, në rastin konkret shpejtësia me të cilën ka vozitur tani i akuzuari ka qenë e përshtatur me rrugën dhe ka qenë e vështirë të vërehet biçiklisti në mungesë të pajisjeve ndriçuese, prandaj eksperti i komunikacionit mendon se për këtë arsye, shkak i aksidentit nuk është tek tani i akuzuari.

Kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me veprën rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1, të KPRK, dhe drejtë ka vepruar kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza konform nenit 364 par.1.nënpar.1.3 të KPPK, për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale, i cili konkludim i shkallës së parë është i pranueshëm edhe për këtë gjykatë.

Duke pasur parasysh rrethanat e lart cekura si dhe duke vlerësuar faktin se përgjegjësia penale duhet të provohet, Kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka pasur vend që të aplikojë institutin juridik "in dubio pro reo", e pranoi mbrojtjen e të akuzuarit se ai nuk është vënë në dilemë me asnjë provë nga përfaqësuesi i akuzës si dhe ekspertizën e ekspertit të komunikacionit dhe e liroi nga akuza.

Nga sa u tha më lartë e sipas dispozitës së nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.959/2018, datë 08.11.2018

Bashkëpunëtorja profesionale
Vjollca Kurtishaj

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

Shqipe Qerimi

Hashim Çollaku